



REPubLIKA E SHQIPERISE
PRESIDENTI

DEKRET

PËR

**KTHIMIN E LIGJIT NR. 9198, DATË 26.02.2004
“PËR NJË SHOQËRI GJINORE TË BARABARTË”**

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës,

Dekretoj

Kthimin për rishqyrtim edhe një herë në Kuvend të ligjit nr. 9198,
datë 26.02.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”.

**Nr. Dekretit 4181
Tiranë, më 23.03.2004**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU**



MOTIVIMI I KTHIMIT
TË LIGJIT NR. 9198, DATË 26.02.2004
“PËR NJË SHOQËRI GJINORE TË BARABARTË”

Të nderuar deputetë,

Më datë 8.03.2004, nga Kuvendi më ka ardhur për t'u dekretuar ligji nr. 9198, datë 26.02.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”, të cilin vendosa të mos e shpall, por bazuar në nenin 85, paragrafi 1, të Kushtetutës, ta kthej edhe njëherë për shqyrtim në Kuvend, për shkaqet e mëposhtme:

- Neni 11 i ligjit të sipërcituar vjen në kundërshtim me nenin 60 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, në rast ankesash lidhur me diskriminimin gjinor, punëmarrësit i drejtojnë pretendimet e tyre tek Avokati i Popullit, i cili bën verifikimin e ankesës. Kushtetuta në nenin 60 të saj përcakton se “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”. Kompetenca që neni 11 i ligjit në fjalë i jep Avokatit të Popullit vjen në kundërshtim me Kushtetutën pasi e zgjeron fushën kushtetuese të veprimtarisë së këtij institucioni. Autoriteti kushtetues i Avokatit të Popullit shtrihet mbi konfliktet që lindin mes qytetarëve dhe administratës publike, ndërsa konfliktet midis qytetarëve dhe entiteteve private apo qytetarëve të tjerë dalin jashtë objektit kushtetues së punës së Avokatit të Popullit.
- Ligji ngarkon Këshillin e Ministrave për hartimin dhe nxitjen e programeve për një shoqëri gjinore të barabartë. Për realizimin e kësaj detyre ligji, në nenet 12 dhe 13 të tij krijon dhe përcakton përbërjen dhe fushën e veprimtarisë së Komitetit Ndërministror. Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, në nenin 11 të tij, e lë në kompetencë të Kryeministrit ngritjen, përbërjen dhe fushën e veprimtarisë së Komiteteve Ndërministrore. Pra, ligji i ardhur për shpallje sjell një situatë konflikti me një ligj tjetër. Ai krijon një organ këshillimor, përcakton përbërjen dhe fushën e veprimtarisë së tij, në një kohë kur ky autoritet i është dhënë Kryeministrit në një ligj organik, i cili është miratuar me shumicë të cilësuar në Kuvend.
- Ligji i ardhur për dekretim, në nenin 13 të tij, nëpërmjet krijimit të Komitetit Ndërministror sjell dhe një faturë financiare, faturë e cila do të përballohet nga Qeveria. Kushtetuta në nenin 82, paragrafi 2, parashikon se “Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së

10

projektligj". Me sa jam unë në dijëni, Këshilli i Ministrave nuk është shprehur për këtë projektligj, duke mos u zbatuar kështu kërkesa kushtetuese për marrjen e pëlqimit të Këshillit të Ministrave.

Të nderuar deputetë,

Ligjet nxirren për të rregulluar marrëdhënie të caktuara shoqërore, duke përcaktuar organe, mekanizma dhe klauzola për garantimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga rregullimi i këtyre marrëdhënieve. Konstatohet, se në vend të tyre ligji ka më tepër elementë deklarativë dhe propagandistikë, me gjithë përpjekjet që janë bërë në dispozita të veçanta. Ky konkluzion mbetet edhe pse krijohet një komitet dhe përcaktohen disa sanksione. Po t'i shikosh në themel, edhe këto dispozita kanë më tepër efekt deklarativ e ndonjë rast bien ndesh dhe me legjislacionin në fuqi.

Mendoj se Kuvendi një ligj si ky duhet paraprakisht t'ia nënshtrojë procedurës së nismës ligjvënëse të ndërmarrë nga Këshilli i Ministrave, jo vetëm për shkak të implikimeve financiare, por edhe për ta sistemuar atë sa më mirë në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe akteve të tjera normative që rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi marrëdhëniet që synon t'i rregullojë ligji i ardhur për shpallje.

Përsa më sipër, dhe duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj,

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU**

